



Universiteti i Elbasanit  
"ALEKSANDËR XHUVANI"



Ky publikim u përgatit nga Klinika e Ligjit pranë Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dhe me mbështetjen financiare të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Përmbajtja e kësaj fletëpalosje është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e donatorit.



**KLINIKA E LIGJIT OFRON KËSHILLIM  
LIGJOR FALAS PËR SHTETASIT NË  
NEVOJË**



### Kontakte

Email:  
info@uniel.edu.al

Website:  
www.uniel.edu.al

Adresa:  
Universiteti i Elbasanit, Elbasan, Shqipëri



KLINIKA E LIGJIT

Universiteti i Elbasanit  
"ALEKSANDËR XHUVANI"

# Klinika e Ligjit

Universiteti i Elbasanit  
"ALEKSANDËR XHUVANI"

**DREJTËSI NË VEPRIM:  
UDHËHEQËSIT E SË NESËRMES,  
AVOKATËT E SOTËM**



# Kush jemi ne?

Klinika e Ligjit, krijuar në **Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"** me mbështetjen financiare të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ofron ndihmë Juridike Parësore, duke i fuqizuar studentët për drejtësi të qasshme në shërbim të komunitetit.

## Çfarë është Ndihma Juridike Parësore?

**Ndihma Juridike Parësore** është një shërbim ligjor pa pagesë i garantuar nga shteti e cila ofrohet për mosmarrëveshjet që mund të zgjidhen pa qenë e nevojshme që t'i adresohesh gjykatës.

## Si mund të përfitoni nga Ndihma Juridike Parësore?

Për të përfituar nga **Ndihma Juridike Parësore** duhet t'i drejtoheni **Klinikës së Ligjit pranë Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"**, nëse kualifikoheni në kategoritë përfituese.

## Klinika e Ligjit ofron këto shërbime:

- ◆ Informon shtetasit për legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- ◆ Informon shtetasit për të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit si dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procese gjyqësore dhe jashtëgjyqësore.
- ◆ Orienton/këshillon shtetasit mbi mënyrën se si ata duhet të veprojnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre.
- ◆ Harton shkresa zyrtare drejtuar institucionit me të cilin subjekti ligjor është në konflikt me qëllim zgjidhjen e problematikës.
- ◆ Ndhmon shtetasit në plotësimin e formularëve për përfitimin e këtij shërbimi dhe në plotësimin e dokumentave që nevojiten.

## Kategoritë që përfitojnë

Të gjithë shtetasit që janë në pamundësi ekonomike dhe që i përkasin kategorive të veçanta.

## Persona të kategorive të veçanta janë:

- viktime të dhunës në familje;
- viktime të abuzimit seksual;
- viktime të trafikimit të qenieve njerëzore;
- viktime të mitur;
- të mitur në konflikt me ligjin;
- fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, si: shtëpitë e fëmijës;
- fëmijë nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisnin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- persona me aftësi të kufizuar dhe të verbërit;
- persona me probleme të shëndetit mendor;
- persona, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, si: fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të rriturit me probleme sociale, fëmijë e të rritur viktime të dhunës në familje, fëmijë e të rritur viktime të trafikimit, individë në varësi të provuar ndaj drogës e alkoolit, vajzat shtatzëna, apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare, të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, të moshuarit në nevojë, familje dhe individë në situatë emergjence etj.;
- person, të cilit i është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi që përbën diskriminim, shprehje e vendimmarrjes së një organi.